

---

# Të dhënat tuaja janë të rëndësishme për NHS

Informacioni rreth shëndetit dhe kujdesit për ju, na ndihmon t'ju ofrojmë kujdes individual, të përshpejtojmë diagnostikimin, të planifikojmë shërbimet tuaja lokale dhe të kërkojmë për trajtime të reja.

Në maj të 2018-s, janë përforcuar rregullat e repta se si duhen dhe nuk duhen përdorur këto të dhëna. NHS është e përkushtuar ndaj mbajtjes në formë të sigurt të informacionit për pacientët si dhe në qenien gjithnjë e qartë për mënyrën se si ky përdoret.

---

Mund të zgjidhni nëse informacioni juaj konfidencial përdoret për kërkim e planifikim.

Për të mësuar më shumë vizitoni: [nhs.uk/your-nhs-data-matters](https://nhs.uk/your-nhs-data-matters)

---

---

## Mund të zgjidhni nëse informacioni juaj konfidencial përdoret për kërkim e planifikim.

---

### Si përdoren të dhënat tuaja

Informacioni juaj shëndetësor dhe i kujdesit përdoret për përmirësimin e kujdesit tuaj individual. Përdoret gjithashtu për të na ndihmuar të kërkojmë për trajtime të reja, të vendosim ku të caktojmë klinikat e përgjithshme, si dhe të planifikojmë për numrin e doktorëve dhe të infermierëve në spitalin tuaj lokal. Kurdo që është e mundur ne përpiqemi të përdorim të dhëna që nuk ju identifikojnë, por ndonjëherë është e nevojshme të përdorim dhe informacione konfidenciale të pacientëve.

### Çfarë konsiderohet informacion konfidencial i pacientit?

Informacioni konfidencial i pacientit ju identifikon juve dhe përmban të dhëna rreth shëndetit, kujdesit apo trajtimit tuaj. Ju keni pritshmërinë që ky informacion të ruhet në formë private. Informacioni që ju identifikon thjesht juve, si p.sh. emri dhe adresa, nuk konsiderohet informacion konfidencial i pacientit dhe mund të përdoret gjithsesi: për shembull, për t'ju kontaktuar nëse klinika juaj e përgjithshme do të bashkohet me një tjetër.

### Kush mund ta përdorë informacionin tuaj konfidencial për kërkim e planifikim?

Ai përdoret nga NHS, autoritetet vendore, studiuesit e universitetit dhe të spitaleve, fakultetet mjekësore dhe kompanitë farmaceutike për kërkimin e trajtimeve të reja.

### Zgjedhja për mospjesëmarrje në mbledhjen e të dhënave

Mund të zgjidhni të mos merrni pjesë në ndarjen e informacionit tuaj konfidencial të pacientit për kërkim e planifikim. Mund të ketë sidoqoftë ende raste kur informacioni juaj konfidencial i pacientit do të përdoret, si p.sh. gjatë një epidemie kur mund të paraqitet rrezik për ju apo për shëndetin e të tjerëve. Ju mund të zgjidhni nëse dëshironi të merrni pjesë në projekte specifike të natyrës kërkimore.

### A do të ndikojë në kujdesin dhe trajtimin tuaj mospjesëmarrja në mbledhjen e të dhënave?

Jo, informacioni juaj konfidencial i pacientit do të përdoret gjithsesi për kujdesin tuaj individual. Kur zgjidhni të mos merrni pjesë në ndarjen e të dhënave, kjo nuk ndikon mbi kujdesin dhe trajtimin tuaj. Do të vijoni të merrni ftesa për shërbimet e kontrollit mjekësor, si p.sh. depistime për kancerin e zorrëve.

### Çfarë duhet të bëj në vijim?

Nuk ka nevojë të bëni ndonjë gjë nëse jeni të kënaqur me mënyrën si përdoret informacioni juaj konfidencial i pacientit.

Nëse nuk dëshironi që informacioni juaj konfidencial i pacientit të përdoret për kërkim e planifikim, mund të zgjidhni në formë të sigurt nga interneti për të mos marrë pjesë, ose nëpërmjet shërbimit telefonik.

---

### Mund ta ndryshoni zgjedhjen tuaj në çdo kohë.

Për të mësuar më shumë ose për të bërë zgjedhjen tuaj vizitoni

[nhs.uk/your-nhs-data-matters](https://nhs.uk/your-nhs-data-matters) ose telefononi në nr. **0300 303 5678**